

Shoqata e kontabilistëve të certifikuar dhe auditorëve të
Kosovës

Society of Certified Accountants and Auditors of Kosovo

Raportimi Financiar

P5

Zgjidhjet

FLETË PROVIMI
Exam Paper

Shënim: Emrat e individëve, vendeve dhe kompanive, të përdorura në këtë provim janë fiktive. Çdo ngjashmëri është plotësisht e rastësishme

Data 20.06.2026

Problemi 1

Më poshtë janë dhënë pasqyrat e përmbledhura financiare të Sirius, Vega dhe Deneb për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2025.

Pasqyrat e të ardhurave për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2025

	Sirius	Vega	Deneb
	€'m	€'m	€'m
Të hyrat	72,000	28,000	19,000
Kosto e shitjeve	<u>(50,000)</u>	<u>(20,000)</u>	<u>(13,000)</u>
Fitimi bruto	22,000	8,000	6,000
Shpenzimet operative	<u>(7,000)</u>	<u>(2,000)</u>	<u>(1,000)</u>
Fitimi para tatimit	15,000	6,000	5,000
Tatimi në fitim	<u>(4,000)</u>	<u>(2,000)</u>	<u>(1,500)</u>
Fitimi për vitin	11,000	4,000	3,500

Pasqyrat e pozitës financiare me 31 dhjetor 2025

	Sirius	Vega	Deneb
	€'m	€'m	€'m
Pasuritë jo-qarkulluese			
Prona, fabrika dhe paisjet	23,000	15,600	10,400
Investimet	<u>6,500</u>	<u>-</u>	<u>-</u>
	29,500	15,600	10,400
Pasuritë qarkulluese	<u>18,000</u>	<u>8,400</u>	<u>4,600</u>
Total pasuritë	47,500	24,000	15,000
Ekuiteti			
Kapitali aksionar – aksionet e zakonshme prej €1	7,000	2,000	2,000
Fitimet e mbajtura	<u>31,000</u>	<u>19,000</u>	<u>10,200</u>
	38,000	21,000	12,200
Detyrimet afatshkurtëra	<u>9,500</u>	<u>3,000</u>	<u>2,800</u>
Total ekuiteti dhe detyrimet	47,500	24,000	15,000

Informatat në vijim janë të rëndësishme:

i) Sirius bleu 1,200 milion aksione të zakonshme prej €1 në Vega me 1 janar 2023 sipas kushteve në vijim:

- një pagesë e menjëhershme në para prej €4,300m; dhe
- një këmbim prej dy aksioneve në Sirius për çdo tri aksione në Vega.

Çmimi i tregut të aksioneve të Sirius me 1 janar 2023 ishte €10 për aksion. Në atë datë Vega kishte fitime të mbajtura prej €10,500 milion.

Pagesa e menjëhershme është regjistruar në pasqyrat financiare të Sirius, por emetimi i aksioneve nuk është regjistruar.

Sirius bleu 500 milion aksione të zakonshme prej €1 në Deneb me 1 korrik 2023 për një kosto prej €4.40 për aksion kur fitimet e mbajtura të Deneb ishin €4,000 milion. Sirius ushtron influencë të madhe mbi operacionet e Deneb.

- ii) Vlerat e drejta të pasurive të Vega ishin të barabarta me vlerat e tyre në libra në datën e blerjës me përjashtim të fabrikës e cila kishte vlerë të drejtë prej €2,000 milion mbi vlerën e saj në libra. Jeta e mbetur e fabrikës ishte 5 vite në datën e blerjës dhe kjo periudhë nuk ka ndryshuar si rezultat i blerjës. Zhvlerësimi i fabrikës është në baza drejtvizore dhe i ngarkohet koston së shitjes. Vega nuk e ka korigjuar vlerën e fabrikës së saj pas përcaktimit të vlerës së drejtë.

Është politikë e grupit të maten interesat jo-kontrollues në datën e blerjës sipas vlerës së drejtë. Interesat jo-kontrollues në blerjen e Vega janë matur në vlerën e tyre të drejtë prej €8 për aksion.

- iii) Gjatë vitit Vega shiti mallra tek Sirius me një çmim të shitjes prej €8,000 milion. Këto shitje janë bërë me një marzhë të fitimit në shitje prej 25%. Me 31 dhjetor 2025 një e katërta e këtyre mallrave janë ende në stoqe të Sirius, por Sirius ka bërë pagesën për to.
- iv) Gjatë vitit Deneb shiti mallra tek Sirius për €1,800 milion. Këto mallra janë shitur me një marzhë prej 20% mbi kosto. Me 31 dhjetor 2025 Sirius ende i kishte të gjitha këto mallra në stoqe.
- v) Me 31 dhjetor 2025 drejtorët e Sirius kryen një rishikim për dëmtim dhe përcaktuan që zëri i mirë i njohur në Vega është dëmtuar për €200 milion. Nuk ka pasur humbje nga dëmtimet në investimet në Deneb.

Kërkohet:

Përgadite pasqyrën e konsoliduar të të ardhurave për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2025 dhe pasqyrën e konsoliduar të pozitës financiare të po asaj date për grupin Sirius. (25 pikë)

Zgjidhja e Problemit 1

1

Grupi Sirius

Pasqyrat e konsoliduar e të ardhurave për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2025

	€'m
Të hyrat (72,000 + 28,000 - (L12) 8,000)	92,000
Kosto e shitjeve (50,000 + 20,000 - (L12) 8,000 + (L12) 500 + (L11) 400)	<u>(62,900)</u>
Fitimi bruto	29,100
Dëmtimi i zërit të mirë	(200)
Shpenzimet operative (7,000 + 2,000)	(9,000)
Pjesa e fitimit të shoqërisë ((3,500 x 25%) - (L12) 75)	<u>800</u>
Fitimi para tatimit	20,700
Tatimi në fitim (4,000 + 2,000)	<u>(6,000)</u>
Fitimi për vitin	14,700
Fitimi i atribuar te:	
Pronarët e prindit	13,540
Interesave jo-kontrollues [(4,000 - (L13) 500 - (L11) 400) x 40%] - (L16)80	<u>1,160</u>
	14,700

Grupi Sirius

Pasqyrat e konsoliduar e pozitës financiare me 31 dhjetor 2025

	€'m
Pasuritë jo-qarkulluese	
Prona, fabrika dhe paisjet (23,000 + 15,600 + (L11) 800)	39,400
Zëri i mirë (L13)	4,000
Investimet në shoqëri (L14)	<u>3,750</u>
	47,150
Pasuritë qarkulluese (18,000 + 8,400 - (L12) 500 - (L12) 75)	<u>25,825</u>
	72,975
Ekuiteti i atribuar pronarëve të prindit	
Kapitali aksionar - aksionet e zakonshme prej €1 (7000 + L13 800)	7,800
Premia e aksioneve L13	7,200
Fitimet e mbajtura (L15)	<u>36,435</u>
	51,435
Interesat jo-kontrollues (L16)	<u>9,040</u>
	60,475
Detyrimet afatshkurtëra (9,500 + 3,000)	<u>12,500</u>
	72,975

1. Korigjimet e vlerës së drejtë

	Në blerje €'m	Lëvizjet €'m	Fundvit €'m
Fabrika	2,000	*(1,200)	800
	2,000	(1,200)	800

* 2,000m/5 vite = €400m në vit x 3 vite

2. Tregtia ndërgrupore

Anulo shitjet/blerjet ndërgrupore:

	€'m
D Të hyrat e grupit	8,000
K Kostot e shitjës së grupit	8,000

Elimino fitimin e perealizuar:

	€'m
D Kosto e shitjeve / Fitimet e mbajtura të Vega (8,000 x 25% x 1/4)	500
K Stoqet e grupit	500

	€'m
D KSH së Deneb/Fitimet e mbajtura të grupit (1,800 x 20%/120% x 25% pjesa)	75
K Stoqet e grupit (pasi që Sirius i mban stoqet)	75

3. Zëri i mirë në Vega

	€'m	€'m
Konsiderata e transferuar		
Paraja		4,300
Aksionet (2/3x1,200mx10)		8,000
Interesat jo-kontrollues (800m aksione x €8)		6,400
Vlera e drejtë e pasurive neto në blerje:		
Kapitali aksionar	2,000	
Fitimet e mbajtura	10,500	
Korigjimet e vlerës së drejtë (L17)	2,000	
		(14,500)
Zëri i mirë në blerje		4,200
Minus: humbja nga dëmtimi		<u>(200)</u>
Zëri i mirë në fund të vitit		4,000
Emetimi i aksioneve do të regjistrohet si në vijim (në librat e Sirius)	€'m	
D Investimet	8,000	
K Kapitali aksionar (2/3x 1,200 x 1)	800	
K Premia e aksioneve (2/3x 1,200 x 9)	7,200	

4. Investimet në shoqëri

	€'m
Kosto e shoqërisë	2,200
Pjesa e grupit e fitimeve pas blerjës (L15)	<u>1,550</u>
	3,750

5. Fitimet e mbajtura

	Sirius €'m	Vega €'m	Deneb €'m
Sipas pyetjës	31,000	19,000	10,200
Provizionet për fitimin e porealizuar (L12)	(75)	(500)	
Lëvizja në vlerën e drejtë (L11)		(1,200)	
Fitimiet e mbajtura para blerjës		<u>(10,500)</u>	<u>(4,000)</u>
		6,800	6,200
Pjesa e grupit e fitimeve të mbajtura pas blerjës:			
Vega (6,800 x 60%)	4,080		
Deneb (6,200 x 25%)	1,550		
Humbja nga dëmtimi (60%x200)	<u>(120)</u>		
	36,435		

6. Interesat jo-kontrollues

	€'m
IJK në blerje (L13)	6,400
IJK pjesa e fitimeve të mbajtura pas blerjës (6,800 L15 x 40%)	2,720
IJK pjesa e dëmtimit të zërit të mirë (200x 40%)	<u>(80)</u>
	9,040

Problemi 2

Informatat në vijim kanë të bëjnë me Adriatik sh.a, një kompani e listuar, për vitin financiar të përfunduar me 31 dhjetor 2025:

- (i) Fitimi para tatimit për vitin ishte €60 milion (2024: €45 milion).
- (ii) Vlera e zvogeluar e pasurive jo-qarkulluese në kontabilitet dhe për qëllime tatimore me 31 dhjetor 2024 ishte €95 milion dhe €90 milion respektivisht. Zhvlerësimi në kontabilitet për vitin është €10 milion (2024: €9 milion) përderisa zhvlerësimi për qëllime tatimore është €8 milion (2024: €7 milion).
- (iii) Gjatë vitit, Adriatik sh.a shiti një makinë për €3 milion dhe njohu një fitim prej €0.5 milion. Vlera e zvogëluar për qëllime tatimore e kësaj makine me 31 dhjetor 2024 ishte €2 milion. Nuk kishte blerje/shitje tjera të pasurive jo-qarkulluese në vitin 2024 dhe 2025.
- (iv) Adriatik sh.a kishte fitime kapitale prej €6 milion (2024: zero) në shitjen e aksioneve të një kompanie të listuar. Ky fitim është i liruar nga tatimi.
- (v) Shpenzimet e borxheve të këqija të njohura gjatë vitit ishin €5 milion (2024: €7 milion).
- (vi) Borxhet e këqija të shlyera të cilat zbriten për qëllime tatimore gjatë vitit arritën shumën prej €3 milion (2024: €4 milion).
- (vii) Detyrimi i tatimit të shtyrë dhe lejimet për borxhet e këqija me 31 dhjetor 2023 ishin €18.90 milion and €9 milion respektivisht
- (viii) Kompania i ka humbjet e bartuara të vlerësuara deri me 31 dhjetor 2023 prej €19.25 milion.
- (ix) Norma e aplikuar e tatimit është 35%.

Kërkohet

Përgadite një shënim për tatime për tu përfshirë në pasqyrat financiare të Adriatik sh.a për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2025 duke dhënë shpalosje të përshtatshme që kanë të bëjnë me shpenzimet aktuale dhe të shtyera të tatimit duke përfshirë edhe informatat krahasuese për 2024 dhe një rikonsilim për të shpjeguar marrëdhënien ndërmjet shpenzimeve të tatimit për 2025 dhe fitimit në kontabilitet për 2025.

Total (20 pikë)

Zgjidhja e Problemit 2

Tatimi	2025	2024
	€m	€m
Aktual (L1)	20.48	10.76
I shtyrë (L12)	<u>(1.58)</u>	<u>(21.35)</u>
	18.90	(10.59)

Marrëdhënia ndërmjet shpenzimeve të tatimit dhe fitimit në kontabilitet

	2025	
Fitimi para tatimit	60.00	
Norma e aplikuar e tatimit 35%	21.00	
Minus: Efekti tatimor i fitimeve të përjashtuara	<u>(2.10)</u>	
	18.90	

L11: Llogaritja e tatimit aktual

Fitimi para tatimit sipas librave	60.00	45.00
Shto: Të ardhurat e lejueshme /Shpenzimet e palejueshme		
Zhvlerësimi në kontabilitet	10.00	9.00
Fitimi i tatueshëm në shitjen e pasurive jo-qarkulluese	1.00	-
Shpenzimet e borxheve të këqija	5.00	7.00
Minus: Të ardhurat e palejueshme /Shpenzimet e lejueshme		
Zhvlerësimi për tatim	(8.00)	(7.00)
Fitimi kontabël në shitjen e pasurive jo-qarkulluese	(0.50)	-
Fitimet kapitale	(6.00)	-
Borxhet e këqija të shlyera	<u>(3.00)</u>	<u>(4.00)</u>
Të ardhurat e tatueshme	<u>58.50</u>	<u>50.00</u>
Detyrimi tatimor (@ 35%)	20.48	17.50

	2025	2024
	€m	€m
L12: Llogaritja e tatimit të shtyrë		
Pasuritë jo-qarkulluese (2024: 95-90, 2025: 82.5-80) (L12.1)	0.87	1.75
Lejimet për borxhet e këqija (2024: 12×35%, 2025: 14×35%) [L12.2]	<u>(4.90)</u>	<u>(4.20)</u>
Saldo në fund e tatimit të shtyrë	(4.03)	(2.45)
Minus: Saldo në fillim	<u>(2.45)</u>	<u>(18.90)</u>
Ngarkesa për vitin	(1.58)	(21.35)

L12.1 Levizjet e Pasurive jo-qarkulluese

	Kontabilitet	Tatime
Saldo në fillim	95.00	90.00
Shitjet gjatë vitit	(2.50)	(2.00)
Zhvlerësimi për vitin - 2025	<u>(10.00)</u>	<u>(8.00)</u>
Saldo në fund	82.50	80.00

L12.2 Levizjet e lejimeve për borxhet e këqija

	2025	2024
Saldo në fillim	12.00	9.00
Lejimet gjatë vitit	5.00	7.00
Të shlyera gjatë vitit	<u>(3.00)</u>	<u>(4.00)</u>
Saldo në fund	14.00	12.00

Problemi 3

Bilanci provues më poshtë ka të bëjë me Propus sh.p.k me 30 shtator 2025:

	në € '000	
	D	K
Prona – sipas vlerës 1 tetor 2024 (shënim (i))	50,000	
Fabrika dhe paisjet – sipas kostos (shënim (i))	76,600	
Fabrika dhe paisjet – zhvlerësimi i akumuluar me 1 tetor 2024		24,600
Shpenzimet e kapitalizuara të zhvillimit – me 1 tetor 2024 (shënim (ii))	20,000	
Shpenzimet e zhvillimit – amortizimi i akumuluar me 1 tetor 2024		6,000
Stoqet në fund me 30 shtator 2025	20,000	
Të arketueshmet tregtare	43,100	
Banka		1,300
Të pagueshmet tregtare dhe provizionet (shënim (iii))		23,800
Të hyrat (shënim (i))		300,000
Kosto e shitjeve	204,000	
Kostot e shpërndarjes	14,500	
Shpenzimet administrative (shënim (iii))	22,200	
Interesi në huamarrjet bankare	1,000	
Dividenda e paguar e ekuitetit	6,000	
Kostot e hulumtimit dhe zhvillimit (shënim (ii))	8,600	
Kapitali aksionar		70,000
Fitimet e mbajtura me 1 tetor 2024		24,500
Tatimi i shtyrë (shënim (iv))		5,800
Teprica e rivlerësimit (Prona)		10,000
	466,000	466,000

Shënimet në vijim janë të rëndësishme:

(i) Pasuritë jo-qarkulluese – të prekshme:

Prona kishte një jetë të mbetur prej 20 vite me 1 tetor 2024. Është politikë e kompanisë që të rivlerësoj pronat e saj në fund të çdo viti. Me 30 shtator 2025 u vlerësua €43 milion.

Me 1 tetor 2024 një zë i fabrikës është shitur për €2.5 milion në para. Të ardhurat janë trajtuar si të hyra nga shitjet nga Propus sh.p.k. Fabrika është ende e përfshirë të shifrën e mësipërme të bilancit provues sipas kostos së saj prej €8 milion dhe zhvlerësimit të akumuluar prej €4 milion (deri në datën e shitjes).

E tërë fabrika zhvlerësohet me 20% në vit duke përdorur metodën e saldos së zbritur.

Zhvlerësimi dhe amortizimi i të gjitha pasurive jo-qarkulluese i ngarkohet kostos së shitjes.

(ii) Pasuritë jo-qarkulluese – të paprekshme:

Përveç shpenzimeve të kapitalizuara të zhvillimit (prej €20 milion), kosto të tjera të hulumtimit dhe zhvillimit janë shkaktuar në një projekt të ri i cili filloi me 1 tetor 2024. Faza e hulumtimit e projektit zgjati deri me 31 dhjetor 2024 dhe shkaktoi kosto prej €1.4. Nga ajo datë projekti pati kosto të zhvillimit prej €800,000 në muaj. Me 1 prill 2025 drejtorët ishin të bindur që projekti do të ketë sukses dhe do të sjell një fitim dukshëm mbi kostot e tij. Projekti është ende në zhvillim me 30 shtator 2025.

Shpenzimet e kapitalizuara të zhvillimit amortizohen me 20% në vit duke përdorur metodën drejtvizore. Të gjitha shpenzimet e hulumtimit dhe zhvillimit i janë ngarkuar kostove të shitjes.

(iii) Propus sh.p.k është duke u paditur nga një klient për €2 milion për shkelje të kontratës lidhur me një urdhër të anuluar. Propus sh.p.k ka marrë një opinion ligjor që ka gjasa 20% që Propus sh.p.k do ta humb rastin në gjyq. Si rrjedhojë Propus sh.p.k ka ndarë provision prej €400,000 (€2 milion x 20%) i përfshirë në shpenzimet administrative. Kostot ligjore të parikuperushme lidhur me mbrojtjen e rastit të cilat janë vlerësuar të jenë €100,000 nuk janë regjistruar pasi që rasti nuk do të shkoj në gjyq deri në vitin tjetër.

(iv) Drejtorët kanë vlerësuar që provizionet për tatimin në fitim për vitin e përfunduar me 30 shtator 2025 janë €11.4 milion. Provizioni i kërkuar i tatimit të shtyrë me 30 shtator 2025 është €6 milion.

Kërkohet:

(a) Përgadite Pasqyrën e të ardhurave për vitin e përfunduar me 30 shtator 2025. (10 pikë)

(b) Përgadite Pasqyra e pozitës financiare me 30 shtator 2025 (10 pikë)

Shënim: shënimët e pasqyrave financiare nuk kërkohen

3.

(a) Propus sh.p.k

Pasqyra e të ardhurave për vitin e përfunduar me 30 shtator 2025	në € '000
Të hyrat (300,000 - 2,500)	297,500
Kosto e shitjeve (L1 (i))	<u>(225,400)</u>
Fitimi bruto	72,100
Kostot e shpërndarjës	(14,500)
Shpenzimet administrative (22,200 - 400 + 100 shih shënimin më poshtë)	(21,900)
Kostot e financimit	<u>(1,000)</u>
Fitimi para tatimit	34,700
(Tatimi në fitim (11,400 + (6,000 - 5,800 tatimi i shtyrë))	<u>(11,600)</u>
Fitimi për vitin	23,100

(b) Propus sh.p.k

Pasqyra e pozitës financiare me 30 shtator 2025

Pasuritë

Pasuritë jo-qarkulluese (L1 (ii))

Prona, Fabrika dhe paisjet (43,000 + 38,400)

81,400

Shpenzimet e zhvillimit

14,800

96,200

Pasuritë qarkulluese

Stoqet

20,000

Të arkëtueshmet tregtare

43,100

63,100

Total Pasuritë

159,300

Ekuiteti dhe detyrimet:

Ekuiteti

Kapitali aksionar

70,000

Fitimet e mbajtura (L1 (iii))

41,600

117,100

Tepricat e rivlerësimit (L1 (iii))

5,500

Detyrimet afatgjata

Tatimi i shtyrë

6,000

Detyrimet afatshkurtëra

Të pagueshmet tregtare (23,800 - 400 + 100 - anulim i veprimit ligjor)

23,500

Mbitërheqja bankare

1,300

Tatimi aktual i pagueshëm

11,400

36,200

Total ekuiteti dhe detyrimet

159,300

Shënim: Pasi që konsiderohet që rezultati i padisë gjyqësore kundër Propus sh.p.k nuk ka gjasa që të ketë suksese (gjasat janë vetëm 20%) është e papërshtatshme që të të njihen provizione. Dëmët potenciale janë një shembull i detyrimit kontigent i cili duhet të shpalojë (€2 milion) si një shënim më pasqyrat financiare. Kostot ligjore të parikuperueshme janë një detyrim (fillimi i veprimeve ligjore është një ngjarje e kaluar) dhe duhet të njihet në tërësi.

Llogaritjet (shifrat në kllapa janë në €'000)

(i) Kosto e shitjeve:	në €'000
Sipas bilancit provues	204,000
Zhvlerësimi (L1 (iii)) – Prona	2,500
– Fabrika dhe paisjet	9,600
Humbja në shitjen e fabrikës (4,000 – 2,500)	1,500
Amortizimi i shpenzimeve të zhvillimit (L1 (ii))	4,000
Shpenzimet e hulumtimit dhe zhvillimit (1,400 + 2,400 (L1 (iii)))	<u>3,800</u>
	225,400
(ii) Pasuritë jo-qarkulluese:	
Prona	
Vlerësimi me 1 tetor 2024	50,000
Zhvlerësimi për vitin (20 vite jetë)	<u>(2,500)</u>
Vlera bartëse në datën e rivlerësimit	47,500
Vlerësimi me 30 shtator 2025	<u>(43,000)</u>
Deficiti në rivlerësim	4,500
Fabrika dhe paisjet sipas bilancit provues (76,600 – 24,600)	52,000
Shitja (8,000 – 4,000)	<u>(4,000)</u>
	48,000
Zhvlerësimi për vitin (20%)	<u>(9,600)</u>
Vlera bartëse me 30 shtator 2025	38,400
Zhpensimet e zhvillimit të kapitalizuara	në €'000
Vlera bartëse me 1 tetor 2024 (20,000 – 6,000)	14,000
Amortizuar gjatë vitit (20,000 x 20%)	(4,000)
Kapitalizuar gjatë vitit (800 x 6 muaj)	<u>4,800</u>
Vlera bartëse me 30 shtator 2025	14,800

Shënim: kostot e zhvillimit mund të trajtohen si një pasuri nga këndvështrimi kur e përmbushin kriteret e njohjes sipas SNK Pasuritë e paprekshme. Andaj, shpenzimet e zhvillimit prej 1 prill deri me 30 shtator 2025 prej €4.8 milion (800 x 6 muaj) mund të kapitalizohen. Këto nuk do të amortizohen pasi që projekti është ende në zhvillim.

Kostot e hulumtimit prej €1.4 milion plus shpenzimet e zhvillimit të tre muajve prej €2.4 milion (800 x 3 muaj) (ato të shkaktuara para 1 prill 2025) trajtohen si shpenzime.

(iii) Levizjet në rezervë

	Teprica e Rivlerësimit	Fitimet e mbajtura
	në € '000	
Saldot me 1 tetor 2024	10,000	24,500
Dividenda		(6,000)
Të ardhurat gjithëpërfshirëse		23,100
Humbja nga rivlerësimi	<u>(4,500)</u>	
Saldot me 30 shtator 2025	5,500	41,600

Problemi 4

Kosova sh.p.k përgadit pasqyrat financiare me 31 dhjetor çdo vit. Është e përfshirë në një varg të aktiviteteve në lokacione të ndryshme. Me 31 dhjetor 2025 kompania kishte në pronësi katër prona.

Pronat AAA dhe BBB janë ndërtuar nga Kosova sh.p.k dhe janë dhënë me qira nga 1 tetor 2025 tek palët e treta. Ndërtimi filloi me 1 gusht 2023 dhe pronat janë përfunduar me 1 tetor 2025. Jeta e përdorimit është vlerësuar të jetë 50 vite me zhvlerësim të plotë në vitin blerjes/përvetësimit dhe pa zhvlerësim në vitin e largimit. Kostot janë si në vijim:

	Prona AAA €'000	Prona BBB €'000
Toka	1,600	1,440
Materialet direkte	1,280	1,120
Puna direkte	320	240
SHPP direkte	<u>210</u>	<u>190</u>
	3,410	2,990

Kosova sh.p.k financoi ndërtimin pjesërisht nga fondet e saj dhe pjesërisht me një kredi prej €6,000,000. Kredia është tërhequr me 1 qershor 2023. Interesi për vitet e përfunduara me

31 dhjetor 2023 ishte €145,000;

31 dhjetor 2024 ishte €280,000 dhe

31 dhjetor 2025 ishte €300,000.

Pronat tjera të Kosova sh,p,k

Detajet me 31 dhjetor 2025	Kosto historike €'000	VNL 1 tetor 10 €'000	Vlera e përdorimit €'000	Vlera e Tregut €'000
CCC	60,000	36,000	28,000	30,000
DDD	64,000	38,000	45,000	48,000

Pronat CCC dhe DDD janë të zëna nga Kosova sh.p.k. Që të dy pronat zhvlerësohen në baza drejtvizore për 50 vite. Tridhjetë përqind e koston së secilës pronë përbën elementin e tokës. Kompania gjithmonë i ka kontabilizuar këto prona duke përdorur modelin e koston, por ka vendosur që nga 1 janari 2025 të përdor modelin e rivlerësimit. Me 1 janar 2025 jeta e përdorimit të këtyre pronave ishte 30 vite.

Kërkohet:

- (a) Shpjego se si secila prej këtyre pronave duhet të kontabilizohet. (6 pikë)
- (b) Trego hyrjet në kontabilitet që duhet të bëhen për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2024 dhe 31 dhjetor 2025. (14 pikë)

Zgjidhja e Problemit 4

a) Pasi që pronat AAA dhe BBB janë dhënë me qira tek palët e treta ato duhet të trajtohen si prona investuese sipas SNK 40 Pronat Investuese. Ka mundësi të trajtimit sipas

- kostos ose
- vlerës së drejtë.

Pasi që nuk janë dhënë detaje të vlerës së drejtë, modeli i kostos duhet të përdoret. Nëse përdoret modeli i kostos, zhvlerësimi duhet të ngarkohet. Pronat CCC dhe DDD janë prona, fabrika dhe paisje brenda fushëveprimit të SNK 16 Prona, fabrika dhe paisjet. Në fillim të gjitha PFP duhet të njihen sipas kostos. Me pas entiteti ka mundësi të zgjedh ndërmjet modelit të kostos dhe modelit të rivlerësimit. Nëse zgjedhet modeli i rivlerësimit, të gjitha pasuritë në atë klasë të pasurive duhet të rivlerësohen.

b)

	Prona AAA	Prona BBB	
Toka	1,600,000	1,440,000	
Materialet direkte	1,280,000	1,120,000	
Puna direkte	320,000	240,000	
SHPP direkte	210,000	190,000	
Kostot e huamarrjës (L1)	<u>324,254</u>	<u>284,317</u>	
	3,734,254	3,274,317	
L11 interesi			
			Periudha
f/v 31 dhjetor 2023			
145,000			1 qershor 2023 – 31 dhjetor 2023
Të lejuara			1 gusht 2023 –31 dhjetor 2023 $5/7 \times 145,000 = 103,571$
f/v 31 dhjetor 2024			
280,000			1 janar 2024 – 31 dhjetor 2024
Të gjitha të lejuara			280,000
f/v 31 dhjetor 2025			
300,000			1 janar 2025–31 dhjetor 2025
Të lejuara			1 janar 2025–30 qershor 2025 $9/12 \times 300,000 =$
			<u>225,000</u>
			608,571
Interesi i ndarë proporcionalisht			
		Prona AAA	Prona BBB
$3,410 + 2,990 = 6,400$			
$3,410/6,400 \times 608,571$		324,254	
$2,990/6,400 \times 608,571$			284,317

	Prona AAA	Prona BBB
f/v 31 dhjetor 2025		
Zhvlerësimi		
(3,734,254-1,600,000)/50	42,685	
(3,274,317-1,440,000)/50		36,686
Pa Tokën		
	Prona CCC	Prona DDD
f/v 31 dhjetor 2024		
Zhvlerësimi		
Kosto historike	60,000	64,000
Pa Tokën 30%	<u>(18,000)</u>	<u>(19,200)</u>
	42,000	44,800
/50 vite	840	896
f/v 31 dhjetor 2025		
Zhvlerësimi		
Shuma e rivlerësuar	30,000	48,000
Pa Tokën 30%	<u>(10,000)</u>	<u>(14,400)</u>
	20,000	33,600
/30 vite	667	1,120
Rivlerësimi		
Në vlerë të tregut	30,000	48,000
Vlera e koston historike		
VNL	<u>36,000</u>	<u>38,000</u>
Fitimi nga rivlerësimi		10,000
Humbja nga rivlerësimi	(6,000)	

Fitimi duhet të tregohet si e ardhur gjithëpërfshirëse, pasi që është rivlerësimi i parë i kësaj prone.

Humbja në rivlerësim duhet të dërgohet tek shpenzimet e periudhës në të cilën ka ndodhur, pasi që nuk ka teprica të rivlerësimi kundrejt të cilave do të mund të aplikohet.

Problemi 5

a) Me janar 2025, Atum sh.a emetoi 500,000 obligacione të konvertueshme për të mbledhur fonde për financimin e një projekti. Çdo obligacion matoron pas tre vjetësh me vlerën nominale prej €100 për obligacion. Çdo obligacion mund të konvertohet në 50 aksione prej €1 në datën e maturimit. Obligacionet mbajnë interes vjetor të pagueshëm me 6%. Norma e interesit të tregut për një obligacion të ngjashëm trevjeçar pa të drejta konvertimi është 9%.

Faktorët e skontimit për 3 vite janë si në vijim:

	Thjeshtë	Kumulativ
6%	0.840	2.676
9%	0.772	2.531

Kërkohet:

Përgatitni ekstraktet e pasqyrës së fitimit ose humbjes dhe pasqyrës së pozitës financiare të Atum sh.a për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2025 për efektet e obligacionit të emeluar.

(6 pikë)

b) Montu sh.a ka përfundimin e vitit me 31 dhjetor 2025. Me 25 nëntor 2025, drejtorët e Montu sh.a vendosën të ristrukturonin biznesin dhe krijuan një plan formal të detajuar për programin e ristrukturimit i cili deri më 31 dhjetor 2025 u ishte komunikuar të gjithë atyre që afektoheshin nga ristrukturimi dhe vlerësuan kostot e ristrukturimit si në vijim:

Kosto	€'000
Ri-trajnimi i stafit për pozitën e reja	1,000
Pagesat e pagave shtesë (dëmshpërblimeve) për ndërprerjen e kontratave të stafit	1,500
Investimi në sistemin e teknologjisë informative për biznesin e ristrukturuar	2,000

Kërkohet:

(i) **Shpjegoni kushtet specifike që duhet të plotësohen për të njohur provizionet për ristrukturim.**

(3 pikë)

(ii) **Llogaritni dhe arsyetoni shumën e provizionit që Montu sh.a duhet të njohë më 31 dhjetor 2025.**

(6 pikë)

Zgjidhja e problemit 5

a) Instrumenti financiar në pyetje është një instrument i përbërë që kërkon kontabilitet të ndarë në përputhje me SNK 32 *Instrumentet Financiare: Prezantimi*.

Më 1 janar 2025, Atum sh.a do të njohë një detyrim afatgjatë prej €46,193,000. Kompania gjithashtu do të rrisë ekuitetin e saj për €3,807,000.

Me 1 janar 2025

Debi	Paraja	50,000,000	
Kredi	Obligacioni		46,193,000
Kredi	Ekuiteti (sal. bal)		3,807,000

Gjatë vitit Atum sh.a do të njohë interes prej €4,157,370.

31 dhjetor 2025

Pasqyra e fitimit ose humbjes	€
Shpenzimet e interesit	4,157,370

Pasqyra e pozitës financiare

Detyrimet afatgjata	
Obligacioni (46,193,000 + 4,157,370 - 6,000,000)	44,350,370

Detyrimet afatshkurtra	
Obligacioni	6,000,000

Llogaritjet

Vlera e tanishme e pagesave të interesit ($500,000 \times 100 \times 6\% \times 2.531$)	7,593,000
Vlera e tanishme e kryegjësë ($500,000 \times 100 \times 0.772$)	<u>38,600,000</u>
	46,193,000

Shpenzimet e interesit $46,193,000 \times 9\% = 4,157,370$

b)

i) SNK 37 *Provizionet, detyrimet kontingjente dhe pasuritë kontingjente* parashtron se në provizionin e ristrukturimit duhet të përfshihen vetëm shpenzimet direkte të cilat dalin në pah gjatë ristrukturimit, dhe të cilat njëllojësisht:

- Janë domosdoshmërisht rrjedhojë e ristrukturimit; dhe
- Nuk kanë të bëjnë me aktivitetet e vazhdueshme të entitetit.

ii) Shuma e provizionit për ristrukturimin e biznesit të Montu sh.a. është €1,500,000 dhe përfshinë vetëm shpenzimet e Pagesave të pagave shtesë (dëmshpërblimeve) për ndërprerjen e kontratave të stafit.

SNK 37 kërkon që të përfshihen vetëm shpenzimet direkte që rrjedhin nga ristrukturimi dhe çdo kosto tjetër që lidhet me aktivitetet e vazhdueshme nuk lejohet të njihet si provizion, siç është rasti i shpenzimeve për ri-trajnimin e stafit dhe Investimet në sistemin e TI-së për Montu sh.a.